

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE  
DREJTORIA E FINANCES DHE BUXHETIT  
SEKTORI I BUXHETIT

Nr. 3442 prot.

Koplik, më 26.12.2024

**PROJEKT- VENDIM**

NR \_\_\_\_ DATË \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024

**“PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2025 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM  
PERFUNDIMTAR 2025-2027 TË BASHKISË MALËSI E MADHE”**


Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024 me propozim të kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenet 9 pika 1.3 shkronja “c”, 18, 34, 40, 41, 54 shkronja “dh”, pika 3, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-29, kreu VII, nenet 39-41, të ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ne udhezimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, në ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, në “Udhezimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV”, “Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 3 datë 28/02/2024 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027”, ne udhezimin plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 datë 5.07.2024 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027, në ligjin nr. 115/2024 datë 3.12.2024 “Për Buxhetin e vitit 2025” ne Aktin normativ nr. 5 datë 19.12.2024, në shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 14488 prot. datë 29.10.2024 “Për Dërgimin e Transfertës së Pakushtëzuar e Përgjithshme dhe Sektoriale për vitin 2025, ne shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 17266 datë 17.12.2024 “Për Dërgimin e Transfertës së Pakushtëzuar e Përgjithshme dhe Sektoriale për vitin 2025” dhe relacionit të Bashkisë Malësi e Madhe,

**PROPOZOJ**

1. Të miratojë buxhetin e vitit 2025 dhe programin buxhetor afatmesëm përfundimtar për vitet 2025-2027 si më poshtë:

1.1 Të miratojë burimet buxhetore për vitin 2025 sipas tabelës nr. 1

- 1.2 Të miratojë Planin e Arkës të burimeve të veta për vitin 2025.
- 1.3 Të miratojë llogaritjen e efektit financiar të lehtësimeve fiskale.
- 1.4 Të miratojë likuidimin dhe parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura.
- 1.5 Të miratojë detajimin e shpenzimeve për vitin 2025 , sipas tabelave përkatëse 2/1, 2/2, 2/3, 2/4,2/5
- 1.6 Të miratojë detajimin e shpenzimeve kapitale sipas programeve sipas tabelës nr.9 të FPT, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Të miratojë programin buxhetor afatmesëm përfundimtar për Bashkinë Malësi e Madhe për vitet 2025-2027.
- a) Të miratojë parashikimin e të ardhurave të viteve 2025-2027
- b) Të miratojë parashikimin e shpenzimeve në nivel programi për shpenzime korrente dhe kapitale sipas tabelës nr.5
- c) Të miratojë tavanet për çdo program për vitet 2025-2027 të programit buxhetor afatmesëm përfundimtar sipas tabelës 1 të FPT (Instrumenti i Planifikimit Financiar) pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- d) Të miratojë të ardhurat sipas përputhshmërisë me rregullat fiskale në fuqi dhe shpenzimet e buxhetit sipas zërave kryesor për dy vitet e mëparshme buxhetore dhe tre vitet e ardhshme , sipas tabelës 2 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- e) Të miratojë detajimin e shpenzimeve sipas klasifikimeve buxhetore për vitet 2025-2027 sipas tabelës 3-5 të FPT pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- f) Të miratojë listën e projekteve të investimeve publike për çdo program sipas tabelës 9 të FPT pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- g) Të miratojë numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Malësi e Madhe dhe institucioneve në varësi të saj për vitin 2025 sipas tabelës B2 të FPT, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Është kompetencë e kryetarit të Bashkisë
- Rishpërndarja e projekteve të investimeve, brenda të njëjtit program:
  - Rishpërndarja ndërmjet zërave të shpenzimeve korrente , brenda të njëjtit program:



3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i Bashkisë.

4.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”,

KRYETAR



TONIN MARINAJ





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA MALËSI E MADHE**


**RELACION**  
**PER**  
**BUXHETIN E VITIT 2025**

---

**DHE**  
**PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESEM**  
**2025-2027**  
**BASHKIA MALËSI E MADHE**



**“Malësia e Madhe është portë hyrëse në Shqipëri, pjesë e Alpeve Shqiptare, me pasuri natyrore dhe kulturore autoktone dhe unike, me histori e tradita, me njerëz punëtorë dhe potenciale të larta për zhvillimin ekonomik, bujqësor, blegtoral, turistik dhe industrial.”**



## Permbajtje


KAPITULLI I.....	5
Kapitulli II.....	12
II.1 Të Ardhurat e Bashkisë për vitin 2024.....	12
II. 1.1 TË ARDHURAT NGA TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE .....	14
II.1.2 TË ARDHURAT NGA TARIFAT VENDORE .....	19
III.1.3 TË ARDHURA TË TJERA .....	21
III.1.4 TË ARDHURA NGA GJOBAT.....	22
II.2 Transferta e Pakushtëzuar.....	23
II.3. TE ARDHURA TE TRASHEGUARA .....	23
II.4 TE ARDHURA NGA TRANSFERTA SPECIFIKE.....	24
Kapitulli III :.....	29
III.1 Shpenzimet korrente.....	29
III.1.1 Shpenzimet e personelit.....	30
III.1.2 Shpenzimet Operative:.....	31
III.1.3 Shpenzime për detyrime të prapambetura dhe vendime gjyqi .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
III.1.4 Transferta të brendshme .....	33
III.1.5 Fondi rezerve dhe kontigjences .....	33
III.1.6 Fondi për Mbrojtjen Civile.....	34
III.2. Shpenzimet kapitale .....	34

## Përshkrim i përgjithshëm mbi Bashkinë.

Të nderuar keshilltarë të Bashkisë Malësi e Madhe!

Pas ndarjes së re territoriale Bashkia Malësi e Madhe tashmë përfshin një territor me një sipërfaqe prej 951.01 km<sup>2</sup> me një densitet prej 56.69 banorë/km<sup>2</sup>, dhe një popullsi prej rreth 54,000 banorë të regjistruar. Bashkia e Malësi e Madhe ka në përbërjen e saj 6 Njësi Administrative: Koplík, Gruemirë, Kastrat, Shkrel, Qendër, dhe Kelmend. Ajo ka nën administrimin e saj dy qytete, Koplík dhe Bajzë dhe 56 fshatra.

Figure 1. Harta Treguese Bashkia Malësi e Madhe



Projekt Buxheti i këtij viti është hartuar duke u bazuar në prioritetet e Bashkisë në mbështetje të plotë të kërkesave të komunitetit për përmirësimin e shërbimeve, rritjen e efikasitetit të infrastrukturës publike, kontrollin dhe mbrojtjen e territorit, me qëllimin kryesor përmirësimin e jetës shoqërore. Buxheti përmbush objektivat strategjike, nevojat dhe kërkesat kryesore të komunitetit. Jemi përpjekur të përdorim mirë burimet ekzistuese për të përcaktuar drejtimin që do të ndjekim në të ardhmen.

Natyrisht ky buxhet nuk mundet të përmbushë të gjitha kërkesat dhe nevojat e komunitetit tonë, por gjithësesi është në funksion të përmbushjes së objektivave strategjike të Bashkisë Malësi e Madhe.



## KAPITULLI I

### PROGRAMI BUXHETOR AFATMESEM 2025-2027

#### PROCESI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM DHE ROLI I TIJ

Hartimi i Buxhetit për vitin 2025 dhe PBA-së për periudhën 2025-2027 përfshihet në një cikël të plotë buxhetimi sipas kërkesave ligjore, duke i ndjekur me rigorozitet të gjithë hapat e percaktuara në ligj. Baza ligjore e programit buxhetor afatmesëm konsiston në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 për "Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"(i ndryshuar), ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" dhe në Udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit vendor. Pasi është bërë identifikimi dhe analizimi i kostove të shërbimeve dhe i investimeve sipas objektivave të programeve dhe shërbimeve sipas standarteve, është realizuar përkthimi i tyre në shifra. Në këtë proces kyç të përgatitjes së PBA-së, morën pjesë të gjitha institucionet dhe ndërmarrjet në varësi si dhe pesë njësitë administrative.

Hartimi i PBA-së përbën një proces shumë të rëndësishëm për Bashkinë Malësi e Madhe, pasi ky program siguron mekanizmat e nevojshme përmes të cilave, objektivat prioritare të identifikuara në Programin Strategjik të Bashkisë së Malësi e Madhe, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor. Baza ku është mbështetur hartimi i PBA-së është programi qeverisës i Kryetarit të Bashkisë Malësi e Madhe si dhe qytetarët e Bashkisë Malësi e Madhe, të cilët në kuadër të "Buxhetimit me Pjesëmarrje", kanë shprehur prioritetet e tyre për shpenzimet publike, nëpërmjet dëgjësive publike nga të cilat janë identifikuar problematikat e komunitetit, përfshirë këtu edhe njësitë administrative.

Pjesë integrale e procesit të përgatitjes së programit buxhetor afatmeësëm janë sektori i financës dhe buxhetit si dhe të gjithë sektorët relevant të Bashkisë Malesi e Madhe. Një format kërkesash buxhetore që lidhet jo vetëm me vlerën monetare të domosdoshme për mirëfunksionimin e punës, por dhe me qëllimin, aktivitetet e kostuara dhe rezultatet që priten me tregues të matshëm, solli facilitet në përzgjedhjen e kërkesave bazuar në fondet e limituara.

#### **Objektivat e Programit Buxhetor Afatmesëm:**

Përmirësimi i menaxhimit të shpenzimeve publike dhe rritja e efijencës së përdorimit të fondeve buxhetore, është objektivi parësor i PBA-së, në funksion të të cilit, angazhimi dhe mbështetja serioze e me përgjegjësi të lartë e të gjitha njësive pjesëmarrëse në PBA, mbetet thelbësore për ecurinë e suksesshme të këtij procesi.

Sigurimi i një shpërndarjeje dhe përdorimi efektiv dhe eficient i burimeve, është objektivi nëpërmjet të cilit synohet të arrihet:

-Një kuadër i qëndrueshëm planifikimi afatmesëm, brenda të cilit të planifikohen buxhetet vjetore,

-Forcimi i lidhjes mes programeve buxhetore të Bashkisë dhe alokimit të burimeve.

### **Qëllimet e Programit Buxhetor Afatmesëm:**

-Kordinimi dhe bashkëveprimi mes strukturave të Bashkisë për të arritur objektivat sipas planit strategjik dhe prioriteteve të politikave zhvillimore, të cilat reflektohen përkatësisht në këtë program.

-Zgjerimi i vizionit të procesit të buxhetimit synon që programet e shpenzimeve të planifikohen në një periudhë afatmesme, mbështetur në objektiva dhe prioritete të vendosura për një periudhë tre vjeçare, për të gjitha programet e shpenzimeve;

-Garnatimi i efektivitetit, efijencës dhe ekonomisë në kryerjen e shpenzimeve publike dhe alokimin e burimeve;

-Zbatimi i disiplinës fiskale i cili mundëson që shpenzimet publike të planifikohen sipas vlerësimit të stabilitetit makroekonomik dhe fiskal.

### **Roli i Programit Buxhetor Afatmesëm:**

Programi Buxhetor Afatmesëm është një instrument nëpërmjet të cilit synohet të arrihet integrimi i politikave të Kryetarit të Bashkisë Malesi e Madhe për mandatin 2023-2027, në plane veprimi lokale të qëndrueshme dhe finalizimin e tyre ne produkte dhe shërbime.



## **Bashkia Malësi e Madhe**

### **Programi Buxhetor Afatmesëm 2025-2027:**

Ky program synon:

a) të informojë Këshillin Bashkiak Malësisë e Madhe dhe publikun e gjerë lidhur me planet afatmesme të shpenzimeve të Bashkisë;

b) t'i japë mundësi Këshillit Bashkiak, si organ vendimmarrës, për të zhvilluar një kuadër të qartë burimesh në periudhë afatmesme që do të shërbejë si bazë për planifikimin e shpenzimeve korrente dhe kapitale të Bashkisë.

Ky proces synon parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve korrente, si një mjet që përkthen qëllimet dhe objektivat strategjike në synime financiare, duke prezantuar politikat fiskale dhe ekonomike të Bashkisë së Malësi e Madhe. Me fjalë të tjera, nëpërmjet këtij programi, Njësitë Shpenzuese kanë mundësinë të përcaktojnë në mënyrë të qartë politikat dhe programet për çdo aktivitet, kostot dhe prioritetet e tyre brenda kontekstit të burimeve të disponueshme, në mënyrë që burimet financiare të mund të alokohen tek programet prioritare në periudhën afatmesme.

Për më tepër, parashikimi i të ardhurave, shpenzimeve dhe përcaktimi i fondeve afatmesme të gatshme për investime, krijojnë mundësinë e vlerësimit të mundësive për t'ju drejtuar partneritetit publik privat dhe lejimin në këtë mënyrë përdorimin e një mjeti alternativ për rritjen e investimeve kapitale, të financuar nga burime të jashtme dhe të brëndshme, në funksion të përmirësimit të infrastrukturës dhe shërbimeve në dobi të komunitetit.

### **Struktura e përgjithshme e Programit Buxhetor Afatmesëm:**

PBA-ja është hartuar në bazë të programeve, ku çdo program lidhet me një funksion të veçantë të pushtetit vendor, brenda të cilit janë përfshirë një ose më shumë Njësi Shpenzuese, në përputhje me funksionet dhe qëllimet përkatëse:

a) Dokumenti i PBA-së, prezanton me detaje qëllimet, objektivat dhe produktet që synohen të arrihen për çdo program.

b) PBA-ja është hartuar për të gjitha programet e Bashkisë dhe është fokusuar në programet prioritare, të cilat janë shprehje e kërkesave dhe nevojave të komunitetit duke u ndërthurur me programin politik të Kryetarit të Bashkisë.

Për çdo program janë parashikuar të gjitha shpenzimet që do të shërbejnë për realizimin e objektivave të tij, sipas llojit dhe Njësive Shpenzuese.

### **Shpenzimet**

- a. Shpenzimet korrente (paga, sigurime, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes, interesa),
- b. Shpenzimet kapitale.

### **Njësitë Shpenzuese:**

- a. Aparati i Administratës së Bashkisë Malësi e Madhe.
- b. Institucionet e varësisë.

### **Prioritetet e Programit Buxhetor Afatmesëm:**

Objektiviti themelor i PBA-së do të jetë kthimi i Bashkisë Malësi e Madhe në një qytet të favorshëm për të jetuar. Ky objektivi do të realizohet përmes mbrojtjes së mjedisit dhe reduktimit të ndotjes, përmirësimit të kushteve në çerdhe, kopshte e shkolla, qendra shëndetësore, përmirësimit të infrastrukturës rrugore, rigjallërimit të jetës kulturore, nxitjes së sipërmarrjes, rritjes së punësimit dhe zhvillimit të ekonomisë rurale dhe turizmit.

## **KUADRI FISKAL DHE EKONOMIK 2025-2027**

Shtyllat kryesore në të cilat është mbështetur hartimi i buxhetit afatmesëm do të jenë pikërisht këto:

Ofrimi i shërbimeve cilësore;

Përmirësimi i infrastrukturës ( sistemime, rikonstruksione)

Garantimi i pastërtisë dhe reduktimi i ndotjes (menaxhimi i mbetjeve)

Rigjallërimi i jetës kulturore dhe sportive;

Rikonstruksioni i shkollave, kopshteve dhe çerdheve

Reabilitimi i qendrave urbane

Digjitalizimi i Shërbimeve

Pastrimi i kanaleve kulluese, mirembajtja rrugëve rurale

Zhvillimi ekonomik dhe nxitja e sipërmarrjes.

Një nga objektivat më të rëndësishëm do të jetë garantimi i pastërtisë në rrugë dhe në hapësirat publike. Gjatë këtij viti do të rikonceptohen dhe strukturohen zonat dhe shërbimet e pastrimit në gjithë territorin e Bashkisë, në kuadër të reformës administrative. Gjithashtu, do të përcaktohet

një vend depozitimi (stacion transferimi) për të gjitha njësitë, që të bëhet grumbullimi dhe kompostimi i mbetjeve urbane dhe më pas transferimi i tyre për në landfill, shërbim i cili do të ofrohet nga sektori i Shërbimeve Publike .

### **Politikat tatimore dhe parashikimi i të ardhurave tatimore për periudhën afatmesme 2025-2027**

Parashikimi i të ardhurave për Bashkinë Malësi e Madhe, është mbështetur kryesisht në llogaritjet e kapacitetit të taksave e tarifave, informacion i siguruar nga programi i taksave vendore, në ecurinë e realizimit të tyre në vite si dhe politikat e përcaktuara për periudhën në vijim, duke u mbështetur në aktet ligjore për to.

Duke qenë se të ardhurat nuk janë realizuar në masën 100% të parashikuara në planin e të ardhurave nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, fenomen ky i cili ka çuar në mosrealizimi i disa projekteve që ishin parashikuar të financohen nga të ardhurat. Ndërsa disa nga projektet e realizuara me afat likuidimi 3 vjeçare janë trashëguar për vitin 2025 e cila reflektohet në parashikimin e rritjes së të ardhurave totale të Bashkisë.

Parashikimet e të ardhurave mbështeten në llogaritjet e përgjithshme që janë të lidhura ngushtë me masat ndërvepruese që pritet të ndërmerren nga administrata tatimore në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Bashkisë por dhe jashtë saj, për realizimin e parashikimeve të pretenduara të të ardhurave.

Parashikimi i të ardhurave për këtë periudhë afatmesme reflekton dhe ndryshimet në paketën fiskale si dhe parashikon rritjen e nivelit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore (2% rritje krahasuar me vitin e kaluar) duke forcuar kapacitetet administruese dhe duke rritur numrin e taksapaguesve;

Në këtë parashikim janë marrë në konsideratë:

- ✓ Rritja e të ardhurave nëpërmjet rritjes së bazës së taksapaguesve dhe shmangien evazionit fiskal (evidentimi i subjekteve mospaguese dhe atyre të reja);
- ✓ Lehtësimi i procedurave në raport me subjektet;
- ✓ Ecuria e realizimit të të ardhurave dhe analiza e detajuar e taksave dhe tarifave, për faktorët që kanë ndikuar në rritjen apo pakësimin e arkëtimeve;

Referuar legjislacionit në fuqi dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak, për paketën fiskale vendore të Bashkisë Malësi e Madhe, për mbledhjen e të ardhurave janë përcaktuar strukturat përkatëse, si më poshtë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore (sektori i të ardhurave dhe i shërbimeve të transportit;



- Strukturat e Aparatit të Bashkisë;

*Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore*, është struktura kryesore, për mbledhjen dhe rakordimin e të gjitha të ardhurave të Bashkisë Malësi e Madhe, e cila jo vetëm arkëton por dhe monitoron të gjitha strukturat e tjera.

*Strukturat e Aparatit të Bashkisë* janë të angazhuara në arkëtimin e tarifave të shërbimit që aplikon vetë institucioni si dhe në taksat që zbatohen direkt prej tyre.

**Tabela Nr. 2**

		2025	2026	2027
	<b>LLOJET E TE ARDHURAVE</b>			
<b>A.1</b>	<b>Te Ardhura TATIMORE</b>			
7002200	<i>Tatim i thjeshtuar mbi fitimin</i>	439	447	456
7020100	<i>Taksa mbi token bujqësore</i>	5,046	5,147	5,250
7020200	<i>Taksa mbi ndertesat</i>	18,687	19,060	19,441
7029200	<i>Taksa mbi kalimin të drejtës për pasuritë e palujtshme</i>	205	209	213
7033016	<i>Taksa e mjeteve të përdorura</i>	31,212	31,836	32,473
7035003	<i>Taksa mbi ndikimin ne infrastrukture</i>	26,072	26,593	27,125
7035005	<i>Taksa fjetjes ne hotel</i>	1,224	1,248	1,273
7035008	<i>Takse vendore e reklames</i>	2,081	2,122	2,165
7035009	<i>Takse vendore e tabelës</i>	680	694	708
7035025	<i>Takse Vendore per truallin</i>	6,630	6,763	6,898
7035026	<i>Takse vendore per ujin</i>	21	22	22
7204100	<i>Nga rente Minerale</i>	122	125	127
7024102	<i>Tatim mbi te ardhurat personale</i>	17,340	17,687	18,041
	<b>Shuma</b>	<b>109,759</b>	<b>111,954</b>	<b>114,193</b>
	<b>TARIFAT VENDORE</b>			
<b>A.2</b>	<b>Të ardhura jotatimore</b>			
7035002	<i>Tarifa e zënies së hapësirës publike</i>	135	138	140
7035007	<i>Tarifa per therje bagetie</i>	32	33	33
7035013	<i>Tarifa e gjelbrimit</i>	832	849	866
7035023	<i>Tarife Vendore ndricimi</i>	1,665	1,698	1,732
7035028	<i>Tarife vendore per certifikaten e perdorimit</i>	1,021	1,041	1,062
7035032	<i>Tarifë vendore për shqyrtim leje zhvillimi</i>	360	367	375
7035034	<i>Tarifë vendore për shqyrtim ose nxjerrje dosje</i>	610	622	635
7035039	<i>Tarife vendore per leje shfrytezim karburantesh</i>	4,200	4,284	4,370
7035040	<i>Tarifë vendore për leje ndërtimi</i>	636	649	662
7035046	<i>Taksë vendore e përkohshme për linjat ajrore e nëntokësore</i>	143	146	149
7110105	<i>Tarifa per akte administrative</i>	1,082	1,104	1,126
7110106	<i>Tarifa leje transporti, autorizime etj</i>	779	795	811
7110501	<i>Tarifa e pastrim, higjene</i>	27,530	28,080	28,642
7111007	<i>Tarife parkingu</i>	416	424	433

	<b>Shuma</b>	<b>39,441</b>	<b>40,229</b>	<b>41,034</b>
<b>A.3</b>	<b>Të ardhura të tjera</b>	-	-	-
7109100	<i>Të ardhura nga qera toke bujqesore</i>	10	11	11
7109200	<i>Të ardhura nga qira trualli</i>	7,315	7,461	7,611
7109600	<i>Te ardhur nga qerate per ndertesat</i>	111	113	116
7109900	<i>Të tjera te ardhura nga nd. dhe pronesia</i>	1,000	1,020	1,040
7111099	<i>Te ardhura te tjera per sherbime</i>	58	59	60
7113001	<i>Të tjera nga shitja e produkteve bujqesore.pyjeve</i>	25	26	26
7113011	<i>Të ardhura nga MNZ</i>	364	371	379
	<b>Shuma</b>	<b>8,884</b>	<b>9,061</b>	<b>9,243</b>
<b>A.4</b>	<b>Gjobat</b>	-	-	-
7115420	<i>Gjoha te Policise Bashkiake</i>	126	129	131
7115499	<i>Të ardhurat nga gjobat</i>	2,000	2,040	2,081
7115500	<i>Të ardhurat nga kamatvonesat</i>	1,020	1,040	1,061
7190990	<i>Të ardhura nga debitorë të ndryshem (në nivel vendor)</i>	100	102	104
		<b>3,246</b>	<b>3,311</b>	<b>3,377</b>
<b>A.5</b>	<b>Të ardhura të tjera</b>	-	-	-
4665100	<i>T. Pulle Gjendja Civile (95% T.Taksa+ 5% a.Tatimor P.L)</i>	-	-	-
7200102	<i>Grant nga nje nivel qeveritar (sponsorizime)</i>	-	-	-
7200102	<i>Grante te huaja</i>	-	-	-
	<b>Shuma</b>	-	-	-
	<b>TE ARDHURA NGA BURIMET E VETA GJITHSEJT</b>	<b>161,329</b>	<b>164,556</b>	<b>167,847</b>
<b>A</b>	<b>TRANSFERTA E PAKUSHTEZUAR</b>	<b>439,869</b>	<b>426,451</b>	<b>442,803</b>
<b>B</b>	<b>TRANSF. DHE TE ARDH. TE TRASHEG.</b>	<b>132,547</b>	-	-
<b>C</b>	<b>Transferta e pagave</b>	<b>54,626</b>	<b>54,626</b>	<b>54,626</b>
	<b>SHUMA A+B+C</b>	<b>627,041</b>	<b>645,633</b>	<b>665,276</b>
<b>D</b>	<b>TRANSFERTA SPECIFIKE</b>	<b>194,920</b>	<b>195,297</b>	<b>195,681</b>
<b>D</b>	<b>TRANSF. SPECIFIKE TE TRASHEG.</b>	<b>31,164</b>	-	-
	<b>TOTALI MIN 00</b>	<b>1,014,456</b>	<b>840,930</b>	<b>860,957</b>
	<b>Ndihma Ekonomike dhe Paaftesia</b>	<b>294,543</b>	<b>315,161</b>	<b>315,161</b>
	<b>0</b>	-	-	-
	<b>GJITHSEJT</b>	<b>1,308,998</b>	<b>1,156,092</b>	<b>1,176,118</b>



## **Shpenzimet sipas programeve nga burimet e veta, transfertat e pakushtezuara dhe specifike dhe transfertat e kushtezuar**

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, percaktuar këto programe buxhetimi.

Tabela e mëposhtme adreson fondet për çdo program, sipas tavaneve bazuar në udhëzimet e fundit të Ministrisë së Financave lidhur me akordimin përfundimtar të fondeve qendrore në rritje që lidhen me transfertën e pakushtezuar dhe transfertën specifike.

## **KAPITULLI II**

### **BUXHETI 2025 ,VITI I PARE I BUXHETIT AFATMESEM 2025-2027**

Buxheti i vitit 2025, si viti i PBA 2025-2027 është bazuar në të njëjtin kuader bazë ligjor si ligji 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligji 9936/2008 “ Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, në ligjin 115/2024 date 3.12.2024 “Për Buxhetin e Vitit 2025” si dhe në Udhëzimin plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 3 date 28.02.2024 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027”

#### **II.1 Të Ardhurat e Bashkisë për vitin 2025**

Sipas nenit 34 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pika 3 dhe 4, njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga qeverisja qendrore dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacione, si dhe burime të tjera, të parashikuara në ligj. Njësitë vendore u garantohet me ligj e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur.

Për vitin 2025 të ardhurat e përgjithshme të Bashkisë Malësi e Madhe nga të gjitha burimet e financimit parashikohen të jenë 1 308 997 489 lekë.

Tabela Nr. 5

Parashikimi i Shperndarjes se Burimeve Financiare për perperiudhen 2025-2027

Në 000/ lekë

Nr	Funksionet	Program	2025			2026			2027		
			Paga Sigurime dhe operative	Investime	Totali	Paga Sigurime dhe operative	Investime	Totali	Paga Sigurime dhe operative	Investime	Totali
1	Planifikimi i Menaxhimit dhe Administrimit	01110	225,751	14,202	239,954	237,039	8,248	245,287	237,395	7,500	244,895
2	Policia Bashkiake	03140	12,510	-	12,510	13,136	-	13,136	13,156	-	13,156
3	Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (I)	03280	40,836	1,455	42,292	42,878	-	42,878	42,942	-	42,942
4	Mbrojtja Civile	03280	10,145	-	10,145	10,652	-	10,652	10,668	-	10,668
5	Kadastra Urbane dhe Zhvillimi Rural	04220	11,499	-	11,499	12,074	-	12,074	12,092	-	12,092
6	Infrastruktura e Ujitjes dhe kullimit	04240	17,786	7,500	25,286	18,675	-	18,675	18,703	-	18,703
7	Administrimi i Pyjeve	04260	36,994	3,597	40,591	38,844	-	38,844	38,902	-	38,902
8	Rrugët rurale	04520	34,355	-	34,355	36,073	-	36,073	36,127	-	36,127
9	Menaxhimi i Transportit rrugore	04520	-	223,424	223,424	-	120,856	120,856	-	99,367	99,367
10	Zhvillimi i Turizmit	04760	6,085	-	6,085	6,389	-	6,389	6,399	-	6,399
11	Menaxhimi i Mbetjeve	05100	43,571	12,700	56,271	45,749	6,764	52,513	45,818	10,000	55,818
12	Planifikimi Urban dhe Strehimi	06140	-	-	-	-	-	-	-	-	-
13	Shërbime publike vendore	06260	20,061	8,120	28,181	21,065	-	21,065	21,097	-	21,097
14	Ndriçimi Rrugor	06440	4,960	-	4,960	5,208	-	5,208	5,216	-	5,216
15	Ujesjelles Kanalizime	06330	-	2,000	2,000	-	-	-	-	-	-
17	Zhvillimi i Sportit	08130	16,723	43,280	60,003	17,560	10,329	27,889	17,586	48,411	65,997
18	Programe specifike kulturore	08220	7,840	-	7,840	8,232	-	8,232	8,244	-	8,244
19	Arsimi baze (perfshi parashkollorin)	09120	116,430	18,681	135,110	122,251	12,036	134,287	122,434	10,186	132,620
20	Arsimi Mesem(I pergjithshem)	09230	20,106	26,161	46,267	21,111	13,022	34,133	21,143	10,304	31,447
21	Arsimi i Mesem(Profesional)+Konviktet	09230	6,205	-	6,205	6,515	-	6,515	6,525	-	6,525
22	Ndihma Ekonomike	10430	17,357	120	17,477	18,225	-	18,225	18,252	-	18,252
23	Fond rezervë	04980	2,000	-	2,000	2,100	-	2,100	2,103	-	2,103
24	Fond kontigjence	04980	2,000	-	2,000	2,100	-	2,100	2,103	-	2,103
	<b>Totali Min. 00</b>		<b>653,215</b>	<b>361,240</b>	<b>1,014,456</b>	<b>685,876</b>	<b>171,255</b>	<b>857,131</b>	<b>686,905</b>	<b>185,768</b>	<b>872,673</b>
	<b>Ndihma Ekonomike dhe Paafesia</b>	<b>10430</b>	<b>294,543</b>		<b>294,543</b>	<b>298,961</b>	<b>-</b>	<b>298,961</b>	<b>303,445</b>		<b>303,445</b>
	<b>GJITHSEJT</b>		<b>947,758</b>	<b>361,240</b>	<b>1,308,999</b>	<b>984,837</b>	<b>171,255</b>	<b>1,156,092</b>	<b>990,350</b>	<b>185,768</b>	<b>1,176,118</b>

Këto të ardhura, sipas ligjit të mësipërm, vijnë nga dy burime të ardhurash si më poshtë:

- A. Nga burimet e veta vendore**, ku përfshihen të ardhurat tatimore (nga taksat vendore), jo tatimore (nga tarifatat për shërbimet publike dhe të ardhurat e tjera).
- B. Nga burimet qendrore**, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar dhe transfertat specifike për funksionet e reja që i transferohen Bashkisë si dhe transfertat e kushtëzuar.

Niveli i transfertës së kushtëzuar dhe të pakushtëzuar përcaktohet çdo vit në ligjin e Buxhetit të Shtetit.

Të detajuara të Ardhurat e Bashkisë Malësi e Madhe për vitin 2025 janë sipas tabelës së mëposhteme:

000/leke

Emertimi	Plan 2025
Të ardhurat nga taksat e tarifat të vitit korrent	161,329
Transferta e pakushtëzuar	494,495
Transferta dhe te ardhura te trashguara nga viti 2024	132,547
Transfertat specifike 2025	194,920
Tranferta specifike te trashguara nga 2024	31,164
Tranferta e kushtebruar	294,543
<b>TOTALI</b>	<b>1,308,998</b>

## II. 1.1 TË ARDHURAT NGA TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE

Të ardhurat nga taksat e tarifat vendore për vitin fiskal 2025 janë parashikuar në shumën 161,329,000 lekë.

Parashikimi i të ardhurave për vitin 2025 mbështetet në zbatim të nenin 35, pika 1, germa a,b,c,dh,e dhe pika 2,3,4,5, germa a,b,c,ç, nenit 36 pika 1 dhe 2, nenit 54 germa “f”, nenit 55 pika 3 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”; Ligjit Nr. 115/2014 datë 31.07.2014 “Për ndarjen administrative-territorale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligjin nr.115 /2024 “Për Buxhetin e Vitit 2025” ; Ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; Ligjit Nr. 9920 datë 19.05 2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar; ne ligjin 68/2017 “Per Financat e Vetëqeverisjes Vendore”. Udhëzimin plotësues të Ministrisë se Financave dhe Ekonomisë nr. 3 datë 28.02.2024 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027”.

Bashkia Malësi e Madhe, garanton funksionin e saj, nëpërmjet taksave të parashikuara ne ligj sipas akteve ligjore, si dhe nga taksat e përkoheshme dhe tarifat , të miratuara nga Këshilli Bashkiak të cilat janë:



## A. TË ARDHURAT E VETA

### 1. Të ardhurat nga Taksat

- ❖ Taksa mbi pasurinë e paluajtëshme
- ❖ Taksa mbi ndërtesen
- ❖ Taksa mbi tokën bujqësore
- ❖ Taksa mbi truallin
- ❖ Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja
- ❖ Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogel
- ❖ Taksa e tabelës
- ❖ Taksa e fjetjës në hotel
- ❖ Taksa të përkohshme
- ❖ Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme
- ❖ Taksa e rregjistrimit të përvitshem të mjeteve të përdorura.
- ❖ Takse vendore e reklames

### 2. Të ardhurat nga Tarifat Vendore

- ❖ Tarifa per akte administrative
- ❖ Tarifa per leje transporti, autorizim etj.
- ❖ Tarifa e ndriçimit
- ❖ Tarifa pastrimi e higjene
- ❖ Tarifa gjelbërimit
- ❖ Tarifa për zënie hapësire publike
- ❖ Tarifa për therje bagëtie
- ❖ Tarifa të tjera
- ❖ Tarife parkingu

### 3. Të ardhura të tjera Vendore dhe Gjoha

- ❖ Të ardhura nga qera toke bujqësore
- ❖ Të ardhura nga qera troje
- ❖ Të ardhura nga qera ndërtese
- ❖ Të ardhura të tjera
- ❖ Të ardhura nga shitja e produkteve bujqësore
- ❖ Te ardhura sekondare dhe pagesa sherbimesh
- ❖ Te ardhura nga sherbimi i MZSH

- ❖ Të ardhura nga gjobat
- ❖ Të ardhura nga kamatvonesat
- ❖ Të ardhura nga debitorë të ndryshem (në nivel vendor)

### 1.1 Të ardhura nga Taksa e pasurisë së paluajtshme

#### 1.2 Të ardhura nga Taksa mbi Tokën Bujqësore

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9632, dt.30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; Ligji nr. 68/ 2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Ligji nr.95/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, dt.30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” taksa mbi token bujqesore per vitin 2025 eshte parashikuar ne vleren 5,045,940 leke.

#### 1.3 Të ardhura nga Taksa mbi ndërtesën

**Baza ligjore:** Ligji nr.106/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore”, të ndryshuar, nenet 22, 22/1, 22/2, 22/3, 22/4, dhe neni 22/5, Vendim i Këshillit të Ministrave, nr.132 datë 7.3.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurive të paluajtshme “Ndërtesa”, Të ardhurat nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme ndërtesë, për vitin 2025 parashikohet të jenë në vlerën **18,686,504** lekë.

#### 1.5 Të ardhura nga Taksa e Trullit

**Baza ligjore:** Ligji Nr. 9632, 30.12.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Ligji nr.95/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, dt.30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Taksa e trullit per vitin 2025 eshte parashikuar ne vlere 6,630,000 leke.

#### 1.6 Të ardhura nga Taksa e fjetjes në hotel

**Baza ligjore:** Ligji nr. 142/2015, datë 17.12.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, neni 26, ANEKSI 8. Strukturat akomoduese përfshijnë kategoritë: Bujtinë, Fjetinë (Hostel), Kamping, Hotel, Motel, Resort, Qendër kurative, Fjetje dhe mëngjes.



**Baza e taksës:** Baza e taksës së fjetes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel. Në vitin 2025 parashikohen të ardhura nga kjo taksë me vlerë **1,224,000** lekë.

### 1.7 Të ardhura nga Taksa e Tabelës dhe e Reklamës

**Baza ligjore:** Ligji nr. 106/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore”, të ndryshuar, neni 8, Aneksi 7 “Taksa e tabelës sipas kategorive të bashkive” Ligji nr.95/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, dt. 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 10.

**Baza e taksës:** Taksa e tabelës zbatohet për të gjitha subjektet, të cilat vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendndodhjes së veprimtarisë, ose brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendndodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike ose private. Përlllogaritja është bërë në bazë të sipërfaqeve të tabelave sipas qëllimit të kategorizimeve të përcaktuara në ligjin 95/ 2018, dhe bazuar në cmimet referuese sipas m<sup>2</sup> për tabelat.

Vlerat e parashikuara për të ardhurat e vitit 2025 nga kjo taksë janë: nga taksa e tabelës për qëllime identifikimi janë **680,422 lekë** dhe nga taksa për tabelë për qëllime reklamimi **2,080,800** lekë.

### 1.8 Të ardhura nga Taksat e ndara

Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 32 i ndryshuar; Ligji nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 11, pika ë, neni 25.

- a- Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme
- b- Taksa vjetore e mjeteve të përdorura
- c- Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare
- ç- Të ardhura nga taksa vendore mbi të ardhurat personale

### 1.9 Të ardhura nga Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë.

**Baza Ligjore:** Ligji 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 28 “Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme” dhe ANEKSI 3 (ndryshuar me ligjin nr. 142/ 2015).

**Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme** vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Për vitin 2025 parashikohen të ardhura me vlerë **205,000** lekë nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë.

### 1.10 Të ardhura nga Taksa vjetore e mjeteve të përdorura

**Baza ligjore:** VKM nr.783, datë 10.11.2011 “Për Procedurat e ndarjes së të ardhurave të Taksës Vjetore të mjeteve të përdorura në njësitë e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar; Ligji nr. 68/ 2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”;; Udhëzimit Nr. 14, datë 30.4.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008, “Për Taksat kombëtare”, i ndryshuar.

**Baza e taksueshme:** Baza e taksës së mjeteve të përdorura është lloji i mjetit të transportit rrugor.

Vlera e parashikuar për të ardhurat nga taksa e mjeteve të përdorura për vitin 2025 është **31,212,000** lekë, kjo e bazuar në të ardhurat e realizuara në vitin 2024 dhe në bazë të informacionit të dhënë nga Drejtoria Rajonale e Transportit Rrugor Shkodër mbi numrin e mjeteve që paguajnë taksë për mjete të përdorura.

#### **Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare**

Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; Ligji nr.68/ 2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 11, pika ë, neni 25.

Vlera e parashikuar për të ardhurat nga taksa e rentës minerare për vitin 2024 bazohet në të ardhurat e realizuara në vitet parardhëse dhe në bazë të informacionit që Drejtoria e të Ardhurave disponon dhe informacionet e marra nga Drejtoria rajonale e Doganave Shkodër dhe Drejtoria e Rajonale e Tatimeve Shkodër. Kjo vlerë parashikohet **122,400**lekë.

#### **Të ardhura nga taksa vendore mbi të ardhurat personale**

Ligji nr.68/ 2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 11 pika 2/e, 25 pika 2/ç.

Taksa vendore mbi të ardhurat personale hyn në kategorinë e “taksave të ndara”. Është taksë kombëtare që një përqindje të saj e marrin njësitë e vetëqeverisjes vendore për të ardhurat që realizohen në juridiksionin e tyre. Bashkisë Malësi e Madhe i kalon një përqindje prej **2%** e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale.

Vlera e parashikuar për të ardhurat nga taksa vendore mbi të ardhurat personale për vitin 2025 është **17,340,000 LEKE**, kjo vlerë bazohet në të ardhurat e realizuara në vitet parardhëse dhe në bazë të informacionit Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

### **1.11 Të ardhura taksat , DREJTORIA E PLANIFIKIMIT URBAN, PROJEKTEVE DHE KADASTRES**

**Baza ligjore:** Ligji 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 27, i ndryshuar me Ligjin Nr. 142/2015, datë 17.12.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar neni 14, Ligji 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” neni 46; Ligji nr. 68 datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 11 pika 2/b; Ligji nr.106/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, të ndryshuar, neni 7; Ligji nr. 9482 datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 25 pika 1 dhe 2 në përputhje me ligjin 9632/2016 i ndryshuar; VKM Nr.408, datë 13.05.2015 “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” i ndryshuar dhe ligjit 107/201 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar.

Të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja është parashikuar në vlerë 26,071,873 leke, te ardhurat nga tarifatat për leje e ndërtimit është parashikuar në vlerë **636,000** lekë, nga tarifa për shqyrtim i dokumentacionit / nxjerrje dosje është parashikuar në vlerë **610,000** lekë dhe te ardhurat nga tarifa për çertifikatë përdorimi janë parashikuar në vlerë 1,020,620 leke. Te ardhurat nga tarifatat për leje zhvillimi është parashikuar në vlerë 360,000 leke.

Në total nga këto taksa dhe tarifa parashikohet që të ardhurat për vitin 2025 të jetë në vlerën **28,698,493** lekë sipas tabelës.



**Tabelë :** Të ardhura nga taksa/ tarifa të urbanistikës

Nr.	TAKSAT/ tarifat nga	Totali i të ardhurave / lekë
1.	Taska e ndikimit ne infrastrukturë	26,071,873
2.	Çertifikate përdorimi	1,020,620
3.	Leje zhvillimi	360,000
4.	Shqyrtim dokumentacioni/ nxjerrje dosje	610,000
5.	Leje ndertimi	636,000
	<b>TOTALI</b>	<b>28,698,493</b>

## II.1.2 TË ARDHURAT NGA TARIFAT VENDORE

### 2.1 Të ardhura nga Tarifa e pastrimit

**Baza Ligjore:** Ligji 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1.3 b. Ligji nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 14 pika 2 dhe 5/b.

*Tarifat e pastrimit dhe shërbimeve publike janë caktuar duke u bazuar ne studimin e kryer nga Bashkia Malesi e Madhe “Plani Lokal për Manaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane në Bashkinë Malësi e Madhe”.*

**Tarifës së pastrimit** i nënshtrohen të gjithë familjet, personat juridikë ose fizikë, vendas ose të huaj, që ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Malësi e Madhe dhe njësisve të saj administrative.

Parashikimi i të ardhurave nga kjo tarifë për vitin 2025 është 27,529,800leke

### 2.2 Të ardhura nga Tarifat e ndriçimit dhe gjelbërimit

**Baza Ligjore:** Ligji 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore; Ligji nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”.

**Tarifa për ndriçimin dhe gjelberimin** është detyrim i çdo taksapaguesi i cili përfiton shërbime të tilla si ndriçim dhe gjelbërim.

Detyrimi për likujdimin e Tarifës ndriçimit dhe tarifës e gjelbërimit lind për Njësinë Adminsitrative Koplík, Qytetin Bajzë dhe fshatrat: Tamarë (qendër), Vermosh (qendër), Razëm (qendër), Dedaj (qendër), Gruemirë (qendër), Koplík i sipërm (qendër) të cilët përfitojnë nga ky shërbim.

Parashikimi i të ardhurave për vitin 2025 llogaritet me vlerën **1,664,640 lekë** nga tarifa e ndriçimit dhe **832,320 lekë** nga tarifa e gjelbërimit në bazë të kapacitetit pagues, numrit të familjeve që marrin këtë shërbim dhe tarifave të Paketës Fiskale 2025.

### 2.3 Të ardhura nga Tarifa të shërbimit administrativ

**Baza ligjore:** Ligji nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1.3; Ligji nr. 68, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 14 pika 5/d, neni 16.

**Përkufimi:** Tarifa për shërbimet administrative është detyrim i cili duhet likujduar përpara marrjes së një shërbimi të caktuar (vërtetime, fotokopje dokumentash, njehsime me origjinalin, etj.) nga administrate.

Për vitin 2025 nga kjo tarifë parashikohen të ardhura me vlerë **1,082,000 lekë**

### 2.4 Të ardhura nga Tarifa për zënie të hapësirës Publike

**Baza Ligjore:** Ligji 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1.3; Ligji nr. 142/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006”, neni 16, pika c, Aneksi 6; VKM nr.1096 i datës 28.12.2015; Ligji nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 14 pika 5/a, neni 15.

Këshilli bashkiak vendos për nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e kësaj tarife si dhe mund të caktojë nivele te ndryshme të kësaj tarife.

Lejet për zënie e hapësirave publike jepen nga zyra e zhvillimit urban sipas planit përkatës.

Për vitin 2025 parashikohet që vlera e të ardhurave nga kjo tarifë të jetë **135,000 lekë**.

### 2.5 Të ardhura nga Tarifa për lejet e transportit

**Baza ligjore:** Kodi rrugor ligji 8378 date. 22.07.1998, “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” neni 7 pika f; Ligji nr. 9632 date 30.10.2006 “Per sistemin e taksave Vendore” i ndryshuar, neni 35, pika 2; Ligji nr.68, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 15 pika 1/c; Ligji nr. 107/ 2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” neni 13, neni 22.

Në bazë të shërbimeve që janë dhënë dhe do të jepen, për vitin 2025 parashikohen të ardhura me vlerën **779,052 lekë** nga tarifa për leje transporti.

### 2.6 Të ardhura nga Tarifa e parkimit të automjeteve

**Baza Ligjore** Kodi rrugor ligji 8378 date. 22.07.1998, “Kodi rrugor i RSH” neni 7 germa 1, f; Ligji nr. 9632 date 30.10.2006 “Per sistemin e taksave Vendore” i ndryshuar, neni 35, pika 2; Ligji nr.68, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 15 pika 1/c; ligji nr. 107/ 2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” neni 13, neni 22 si dhe VKB nr. 21 datë 29.06.2016 “Për miratimin e projektit “Rehabilitimin e Qendres së Qytetit Koplik”.

Për vitin 2025 parashikohen të ardhura me vlerë **416,000 lekë** nga tarifa e parkimit të automjeteve.

### 2.7 Të ardhura nga Tarifa për therje bagëtie

**Baza Ligjore:** Ligjit nr. 139/ 2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore” neni 9, pika 1.3, germa b; Ligji nr.10465, date 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, neni 54, Akti Normativ Nr.4 datë 16.08.2012 “Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregtimin e mishit të tyre” neni 7, pika 2 dhe Vendimin Nr.230 datë 20.03.2013 “Për përcaktimin e funksioneve, detyrave specifike dhe standarteve të shërbimit veterinar të qeverisjes vendore”, kreu IV, pika 6 dhe 7. Ligji nr. 68/ 2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes



Vendore”, neni 14 pika 5/ë. Vendim Nr. 475, datë 30.7.2021 “Për bashkëpunimin e njësive të vetëqeverisjes vendore me shërbimin veterinar”

Tarifa për shërbimet veterinare përfshin kontrollin nga ana e inspektoriatit veterinar dhe vulosjen e bagëtive.

Llogaritja për të ardhurat është bërë në bazë të numrit të thertoreve që shtirjnë aktivitetin e tyre në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe dhe gjithashtu në bazë të informacionit që disponon Zyra e Inspektoriatit Veterinar për numrin mesatar të therjeve në vit.

Për vitin 2025, parashikohet që nga ky zë të grumbullohen të ardhura me vlerë **32,000 lekë**.

**Tabelë 1.** Të ardhura nga tarifa per therje bagëtie

### **2.8 Të ardhura nga Tarifa e përkohshme për nëntokësore**

**Baza ligjore:** Ligji.nr.139/2015, dt.17.12.2016 “Për vetëqeverisjen vendore“, neni 35, pika 5, gërma ç, ligji 68, datë 27.04.2017, datë 27.04.2017 Për financat e vetëqeverisjes vendore“, neni 14 pika 3 dhe pika 5/dh”. Ligji nr.95/ 2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, dt.30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 12.

Në bazë të informacionit të disponuar nga Sektori i Zhvillimit Urban për dhëniet e lejeve nëntokësore parashikohen të ardhura me vlerë **143,250 lekë**.

### **2.9 Të adhura nga Tarifë vendore për leje Shfrytëzim Karburantesh.**

**Baza Ligjore:** Ligji nr.8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” i ndryshuar, neni 20 pika 2; VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, Kreu II, pika 1, gërma b, pika 3 i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 970, datë 2.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”; Ligji 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 14 pika 5/ë.

Në bazë të numrit të karburanteve të cilëve ju mbaron afati i autorizimeve dhe karburanteve të cilat pritet të fillojnë aktivitetin në vitin 2025 në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe, nga kjo tarifë parashikohen të ardhura në **vlerën 4,200,000 lekë**.

## **III.1.3 TË ARDHURA TË TJERA**

**Baza Ligjore:** Në bazë të ligjit 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 36 të ardhurat nga burime të tjera të bashkive janë: të ardhurat nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të bashkisë; të ardhurat nga investimet mbi kapitalet; të ardhurat nga titujt dhe të drejtat e tjera të blera nga bashkia; të ardhurat nga fitimi i ndërmarrjeve publike në pronësi; të ardhurat nga partneritetet privat-publik.

Bashkitë krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre ekonomike, qiratë dhe shitja e pronave, dhuratat, interesat, gjobat, ndihmat ose donacionet. Dhe mund të krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre kulturore, sportive, etj. Keto të ardhura per vitin 2025 jane parashikuar ne vlere 8,883,660 leke sipas tabelës



**Tabelë: Te ardhura te tjera.**

Nr.	Të ardhura të tjera	Të ardhurat/ lekë
1.	Të ardhura nga qira toke bujqësore	10,400
2.	Të ardhura nga qira trualli	7,315,100
3.	Të ardhura nga qiratë për ndërtesat	111,160
4.	Të ardhura nga nd. dhe pronësia	1,000,000
5.	Të ardhura të tjera për shërbime	58,000
6.	Të ardhura nga MNZ	364,000
7.	Të ardhura nga shitja e produkteve bujqësore, pyjeve etj.	25,000
	<b>TOTALI</b>	<b>8,883,660</b>

### III.1.4 TË ARDHURA NGA GJOBAT

**Baza ligjore:** Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 6, pika b, neni 7, pika ç, neni 10, pika 3 dhe neni 12; Ligji nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për Policinë Bashkiake” i ndryshuar, neni 13; Ligji nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 25; Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 164/ 2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar neni 22, ligji nr. 139/ 2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 8 pika 2, neni 23, neni 9 pika 1, 3 pika b, neni 54 pika n;” VKM nr. 1096/ 2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve dhe procedurave për përdorim dhe menaxhimin e hapësirës publike” neni 4, 12, dhe 14; Vendimi

nr. 408 dt.13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar, neni 7 iii; Ligji nr. 10/ 2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për Transportin rrugor” i ndryshuar; Ligji nr. 68 ,datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 61, pika 5 dhe 6.

Për vitin 2025, nga ky zë parashikohen të ardhura me vlerë **3,246,000** lekë.

Parashikimi është bërë duke ju referuar trendit të të ardhurave ndër vite nga gjobat e policisë bashkiake, nga kamatvonesat për shlyerje pas afatit të detyrimit tatimor të bizneseve, dhe nga gjobat e vendosura nga Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit.

**Tabelë: Të ardhura nga gjoba**

Nr.	Emërtimi	VLERA
1.	Të ardhurat nga kamatvonesat	1,020,000
2.	Të ardhura nga debitorë të ndryshëm (në nivel vendor)	100,000
3.	Gjopa te Policise Bashkiake	126,000
4.	Gjopa te tjera	2,000,000
	<b>TOTALI</b>	<b>3,246,000</b>

## II.2 Transferta e Pakushtëzuar

Transferta e pakushtëzuar që buxheti qendror ia transferon pushtetit vendor përfshin fondet për përballimin e veprimtarive dhe funksioneve të Bashkisë percaktuara në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore“ e përfituar në formën e dhurimit pa kusht kthimi, pa interes, e cila përdoret për financimin e shpenzimeve për funksionet e veta dhe të përbashkëta të Njësive të Qeverisjes Vendore, e përcaktuar në ligjin 115/2024 , “Për Buxhetin e vitit 2025”

Si rregull i përgjithshëm, transferta e pakushtëzuar duhet t’u sigurojë NJQV-vë diferencën mes kostos së ushtrimit të funksioneve (nevojat për shpenzime) dhe të ardhurave që ato krijojnë në mënyrë të pavarur (kapaciteti fiskal). Duke qenë se NJQV-të janë të ndryshme për sa i përket nevojave dhe kapacitetit fiskal, në një sistem efikas dhe të barabartë të ndarjes së transfertës së pakushtëzuar duhet të merren parasysh diferencat tek të dy dimensionet.

Formula e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar identifikon nevojat për shpenzime të bashkive duke u bazuar në 3 kritere : a) popullsia relative, b) dendësia e popullsisë për çdo njësi (që kap diferencat në koston e ushtrimit të funksioneve ndërmjet bashkive) dhe c) numri faktik i nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në çdo bashki. Përveç ekualizimit të kostove që bëhet nëpërmjet komponentit të dendësisë, formula e re e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar sjell edhe ekualizimin e kapacitetit fiskal (të matur nga të ardhurat faktike nga taksat e ndara ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj vendore), të cilat mblidhen dhe u transferohen plotësisht ose pjesërisht bashkive nga administrata tatimore qendrore. Ekualizimi fiskal bazohet në të ardhurat faktike nga tatim fitimi i thjeshtuar i biznesit të vogël, nga taksa vjetore e automjeteve të përdorura dhe taksa e kalimit të pasurisë për pasuritë e paluajtshme të shitura nga personat juridikë.

**Për vitin 2025 transferta e përgjithshme e pakushtëzuar për Bashkine e Malesisë e Madhe paraqitet në shumën 494,495,000 lekë.**

## II.3. TE ARDHURA TE TRASHEGUARA

Bazuar në nenin 40 pika të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore“ Neni 40 pika 1 “Njësitë e vetëqeverisjes vendore kryejnë shpenzime, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përputhje me parimet e disiplinës fiskale, menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi të burimeve të tyre financiare. Të ardhurat e veta të njësive të vetëqeverisjes vendore, që nuk janë shpenzuar brenda vitit fiskal, trashëgohen në vitin tjetër fiskal.

Bazuar sa më sipër për nga viti 2024 janë trashëguar për vitin 2025 fondet si më poshte:



<b>Transfertat nga 2024</b>	<b>Vlera në lekë</b>
Te Trash.2024 (Grant )Kap 01	114,141281
Te Trash.2024 (Ardh)Kap 02	0
Te Trash.2024 (Ardh ))(Grant Kap 05	48,305,904
Te Trash.2024 (Specifike )Kap 01	31,164,396
Te Trash.2024 (Ardh. )Kap 06	152,070
<b>Shuma</b>	<b>193,763,651</b>

#### II.4 TE ARDHURA NGA TRANSFERTA SPECIFIKE

Funksionet e reja që iu transferuan bashkive në vitin 2016, me Ligjin nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” do të vazhdojnë të financohen nëpërmjet transfertës specifike edhe në buxhetin e vitit 2025.

Më konkretisht:

- Personeli edukativ dhe mbështetës në arsimin parashkollor
- Personeli mbështetës i arsimit para-universitar
- Rrugët rurale rajonale
- Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri
- Shërbimi pyjor
- Ujitja dhe kullimi Këto funksione financohen nga Buxheti i Shtetit nëpërmjet transfertave specifike.

Në këto transfertat bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve, shpenzimet operative dhe investime.

Ministritë e linjes , duhet të transferojnë në Bashki, inventarin e mjeteve, godinave dhe asetëve të tjera. Gjithashtu, duhet t’i dërgojnë Bashkisë të gjithë dokumentacionin që lidhet me personelin e këtij shërbimi, kuadrin ligjor dhe të dhëna të tjera që disponon të cilat janë të lidhura me shërbimin.

**Funksionet e transferuara janë si më poshtë:**

##### 1. Infrastruktura e Ujitjes dhe Kullimit.

Në transfertën specifike të vitit 2025, janë fondet për ujitjen dhe kullimin. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.



## **2. Administrimi i Pyjeve**

Në transfertën specifike të vitit 2025, janë fondet për Shërbimin Pyjor. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

## **3. Rrugët rurale (Mbroj.e.prodh.Bujq,blek.agro)**

Në transfertën specifike të vitit 2025, janë fondet për rrugët rurale të transferuara nga qarku në bashki. Në këto fonde bëjnë pjesë fondet për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në rrugët.

## **4. Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar**

Në transfertën specifike të vitit 2025, janë fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor si dhe fondet për personelin ndihmës të arsimit parauniversitar. Në fondet e personelit ndihmës të arsimit parauniversitar nuk përfshihet arsimi i mesëm profesional. Ministria e Arsimit dhe Sportit, para fillimit të vitit buxhetor 2025 dërgon në Bashkitë përkatëse kuadrin ligjor dhe nënligjor lidhur me dosjet personale të punonjësve, pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor, personelin ndihmës të arsimit parauniversitar. Në këto fonde bëjnë pjesë fondet për paga dhe sigurime shoqërore. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

## **5. Arsimi i Mesem(Profesional)+Konviktet(Konvikti Tamare)**

Në transfertën specifike të vitit 2025, disa bashkive ju akordohen fonde për konviktet e arsimit parauniversitar. Në këtë transfertë përfshihen: fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukator), shpenzimet operative dhe shpenzimet për investime. Shpenzimet për personelin (paga dhe sigurime shoqërore) janë llogaritur mbështetur mbi numrin e punonjësve për secilin konvikt sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 502, datë 16.04.2008, “Për administrimin e konvikteve të sistemit arsimor parauniversitar” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1710, date 29.12.2008, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 502, date 16.04.2008”, për punonjësit edukative (zëvendës drejtor dhe edukator).

Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore të personelit të këtyre konvikteve, njësitë e vetëqeverisjes vendore do të mbështeten në kuadrin rregullator që ka përdorur Ministria e Arsimit dhe Sportit. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

#### 6. Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH)

Në transfertën specifike të vitit 2025, janë fondet për Policinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Ministria e Punëve të Brendshme duhet t'ju dërgoj bashkive të gjithë dokumentacionin që lidhet me personelin e këtij shërbimi, kuadrin ligjor dhe të dhëna të tjera që disponon të cilat janë të lidhura me shërbimin. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

Konkretisht për vitin 2025 në bazë të shkresës nr.14488 dt.29/10/2024 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Financave Vendore janë alokuar **transferrat specifike** si më poshtë:

Nr.	Emertimi i transfertes specifike për vitin 2025	Vlera në lekë
1	Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (PMNZSH)	36,036,000
1	Menaxhimi I Mbetjeve	6,048,000
2	Infrastruktura e Ujitjes dhe kullimit	15,501,000
3	Administrimi i Pyjeve	20,482,000
4	Rrugët rurale	16,472,000
5	Arsimi baze (përfshirë parashkollorin)	89,002,000
6	Arsimi Mesëm	6,732,000
7	Konviktet e Arsimit Parauniversitar	4,647,000
	<b>Shuma transfertë Specifike</b>	<b>194,920,000</b>

Gjithashtu nga viti 2024 janë trashëguar fondet nga transferta specifike si me poshte:

Nr.	Emërtimi i transfertes specifike	Vlera në lekë
1	Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (PMNZSH)	6,255,875
2	Infrastruktura e Ujitjes dhe kullimit	9,784,689
3	Administrimi i Pyjeve	3,014,974
4	Rrugët rurale	1,100,061
5	Arsimi baze (perfshi parashkollorin)	10,060,625
6	Arsimi Mesem(I pergjithshem+ konvikti)	948,172
	<b>Shuma transferte Specifike te trashëguar nga 2024</b>	<b>31,164,396</b>



## Transferta e kushtëzuar për vitin 2025

Transferta e kushtëzuar është fond që i jepet pushtetit vendor nga Buxheti i Shtet, i cili duhet të përdoret vetëm për qëllimin dhe sipas rregullave të vendosura nga pushteti qendror. Tabela e mëposhtme paraqet fondin e transfertës së kushtëzuar për vitin 2025, fond i cili ka vlerën prej **294 543 000** lekë.

Fondet e kushtëzuara për financimin e funksioneve të deleguara, nuk miratohen si pjesë përbërëse e buxhetit të njërive vendore, por reflektohen në dokumentin e realizimit të buxhetit, si fonde të administruara nga njësitë vendore. Sipas akteve ligjore në fuqi, funksione të deleguara në pushtetin vendor janë:

*Shërbimi i gjendjes civile* si funksion i deleguar i detyrueshëm, parashikimi i shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime që bëhen nga bashkitë, në bazë të kuotave dhe udhëzimeve të detajuara bëhen nga Ministria e Brendshme. Numri i punonjësve dhe kuotat përkatëse për këtë funksion përcaktohen nga Ministria e Punëve të Brendshme.

*Qendrat e Rregjistrimit të Bizneseve*, si funksion i deleguar i detyrueshëm, parashikimi i shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative bëhet nga bashkitë, në bazë të kuotave dhe udhëzimeve që bëhen nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

*Përkrahja sociale*, si funksion i deleguar i detyrueshëm, Ministrisa e Shëndetësisë dhe Mbrotjes Sociale detajon në fillim të vitit fondet për përkrahjen sociale për çdo njësi të qeverisjes vendore, në mënyre specifike për ndihmën ekonomike dhe për pagesën e paaftësisë.

### **KAPITULLI III : PARASHIKIMI SHPENZIMEVE NE BUXHETIN E BASHKISË MALËSI E MADHE PER VITIN 2025**

Shpenzimet e përgjithshme të Bashkisë Malësi e Madhe për vitin 2025 për të gjitha funksionet e saj janë programuar në lekë.

Politikat e ndjekura nga Bashkia Malësi e Madhe në planifikimin e shpenzimeve ne buxhetin e vitit 2025 synojnë në:

- Racionalizim e shpenzimeve administrative në bazë të normimit të tyre.
- Reduktim të shpenzimeve të personelit të administratës
- Shlyerjen e detyrimeve të prapambetura nga viti i mëparshëm .
- Rritjen e shpenzimeve në shërbimet publike duke iu përgjigjur shtrirjes së re territoriale të Bashkisë Malësi e Madhe, nevojave të komunitetit dhe tendencës të rritjes së investimeve në vite,
- Planifikimin e investimeve prioritare duke sjellë cilësi në rritje në dy drejtime:
  - ◇ Të vlerësimit e zgjedhjes së projekteve të investimeve duke mbajtur parasysh kërkesat më emergjente dhe të domosdoshme për plotësimin e nevojave të komunitetit,
  - ◇ Sigurimin e shpërndarjes me përparësi të investimeve në projekte të rëndësishme të bazuara në vlerësime dhe studime paraprake.

Tabela Planifikimi i buxhetit sipas klasifikimit ekonomik duke përfshirë transfertën specifike dhe transfertën e kushtëzuar

#### **III.1 Shpenzimet korrente**

Shpenzimet korrente të Bashkisë Malësi e Madhe për vitin 2025 parashikohen në shumën 947 757 722 lekë dhe përbëjnë 72 % të totalit te shpenzimeve për këtë vit.

Shpenzimet korente përbëhen nga:

- Shpenzime për personelin
- Shpenzime operative
- Ndihma Ekonomike dhe Paaftesia
- Transferta korente të brendshme (Kontributi per Qarkun)  
Fondi rezerve dhe i kontigjences.

Shpenzimet korrente në total sipas programeve te Bashkise Malësi e Madhe paraqiten si në tabelën e mëposhteme:

Emertimi	Paga	Sigurime	Shpenzime Operative	Transferta Kuota qarkut	Investime	Ndihma ekonomike dhe Paaftesia	Fond Rezerve ,fond I vecante & Kontigjencës	TOTALI
<b>TOTALI</b>	<b>395584955</b>	<b>65,962,747</b>	<b>161,361,865</b>	<b>1800000</b>	<b>361,239,752</b>	<b>294,543,000</b>	<b>28,505,170</b>	<b>1,308,997,489</b>

### III.1.1 Shpenzimet e personelit

Për vitin 2025 nr. i punonjësve të Bashkisë Malësi e Madhe do të jetë 506 punonjës.

Tabela e fondit të pagave sipas programeve dhe transfertave për vitin 2025

Ministria e Brendshme	00
Bashkia M.Madhe	130
Malesi e Madhe	332
	3

VITI 2025

Shtojca Nr. 6

Raportimi i Fondit te Pagave dhe Numrit te Punonjesve te njesise se qeverisjes vendore

Emertimi	K O D E T		Viti 2025	
	Kapitulli	Programi	Numri i punonj.	Fondi i pagave (ne leke)
sipas programeve				
<b>Transferte e pakushtezuar 2024</b>				
Planifikimi i Menaxhimit dhe Administrimit	01	01110	146	89,372,965
Policia Bashkiake	01	<b>03140</b>	12	11,391,120
Kadastra Urbane dhe Zhvillimi Rural	01	<b>04220</b>	10	11,399,212
Infrastruktura e Ujitjes dhe kullimit	1		1	
Administrimi i Pyjeve	01	04260	23	11,826,600
Mirembajtje Ruget	01	04520	10	9,399,343



Zhvillimi I Turizmit	01	<b>04760</b>	4	4,235,160
Menaxhimi i Mbetjeve	01	<b>05100</b>	41	24,251,004
Sherbime publike vendore	01	06260	19	16,191,444
Ndriçimi Rrugor	01	<b>06440</b>	2	1,460,400
Zhvillimi i Sportit	01	<b>08130</b>	5	4,953,360
Arsimi baze (perfshi parashkollorin)	01	09120	24	-
Arsimi Parauniversitar(P Mbeshtetes)	01	09230	4	2,677,445
Konvikti	01	09230		984,623
Ndihma Ekonomike dhe Paaftesia	01	<b>10430</b>	16	16,989,876
<b>Shuma Transferte e pakushtezuar</b>			<b>317</b>	<b>205,132,552</b>
<b>Transferte Specifike</b>				
Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (PMNZSH)	01	03280	27	32,421,595
Infrastruktura e Ujitjes dhe kullimit	01	04240	9	9,111,696
Administrimi i Pyjeve	01	04260	22	18,802,788
Rrugët rurale	01	04520	26	17,572,452
Arsimi baze (perfshi parashkollorin)	01	09120	80	99,062,751
Arsimi Mesem(I pergjithshem)	01	09230	10	7,107,530
Konvikti	01	09230	8	4,610,882
<b>Shuma Specifike 2024</b>			<b>182</b>	<b>188,689,694</b>
Administrata e Bashkisë	05	01110		82,086,066
<b>Shuma te ardhura nga 2024</b>				<b>82,086,066</b>
<b>Totali</b>			<b>499</b>	<b>475,908,312</b>

Pagat do mbulohen kryesisht nga Transferta e Pakushtëzuar, përveç pagave të Administratës të cilat do të mbulohen nga ndërthuarja e transfertës së pakushtëzuar dhe nga të ardhurat e veta, përkatësisht me grant ne shumen 89,372,965 leke dhe 82,086,066 lekë me të ardhurat e veta.

### III.1.2 Shpenzimet Operative:

Shpenzime operative janë në total në shumën 161,361,865 lekë ,

- ❖ Planifikim Menaxhim Administrim jane 52,492,465 si më poshte:

Regjistrim fillestare per pronat jashte sistemit hipotekore, 9,572,400 leke ,Mirmbajte Objekti per Njesite Administrative 3,000,000 leke, Shpenzime energji 2 504,561 lekë , Udhetime per keshilletaret 2, 000 ,000 leke, Posta dhe sherbimi korrier 2,000,000 lekë, ndersa pjesa tjeter

karburant, kanceleri, boje printeri material pastrimi, materiale të ndryshme, Shpenzime per keshillin 600 000 leke ,siguracione per makina 100,000 etj.

❖ Shpenzime operative per sherbimet publike vendore 3,870,000 lekë  
Pjesen kryesore e zene Dekorim per festa 960,000 lekë, Pjese kembimi 700, 000lekë,  
Material hidraulike 450,000 leke ndersa pjesa tjeter jane veshje pune per punonjesit,  
vegla pune dhe dokumentacion per makinerite, lëndë për kujdesin e lulishteve, etj.

❖ Shpenzime operative per Menaxhimin e mbetjeve ne vleren 19,319,717 lekë  
Pjesen kryesore e zene Karburant dhe vaj 1,218,042 lekë, pjese kembimi 2,250,000  
lekë, Depozitime Landafill 6,500,000 lekë ; ndersa pjesa tjeter jane veshje pune per  
punonjesit, vegla pune dhe dokumentacion per makinerite, fushatë ndërgjegjësimi,  
etj.

❖ Shpenzime operative per Sportin ne shumen 11,770,000 lekë.  
Pjesen kryesore e zene pagesat per futbollistat 8,000,000, Dieta 500,000  
lekë, Transport futbollistash 1,200,000 leke, Pagese Federata 100,000 leke, qera  
fushë 650,000 leke, ndersa pjesa tjeter jane kostume sportive 500 000, materiale  
sportive 250,000 etj.

❖ Shpenzime operative per Kulturen 7,840,000 leke  
Pjesen kryesore e zene Emisione per Xhubleta 300,000 leke, Folk fest 400, 000,  
Lojera popullore Fest 600, 000, Logu i Bjeshkeve 1,600,000 lekë, Festa e Reçit  
500,000 lekë, Iftar per Ramazan 300,000 lekë, Qera ambjenti + dekor 200,000 lekë,  
etj.

❖ Shpenzime operative per Arsimin bazë 17,367,100 leke.  
Te perbera nga: Mirembajtje shkollash 5,000,000 lekë, Energji 1,510,000 lekë,  
Materiale pastrimi 650,000 lekë, Blerje Pelet per Ngrohje 4,000,000, Shperblim i  
nexenesve ekselente 1,380,000 leke, ndersa pjesa tjeter jane Kanceleri, bojëprinteri,  
materiale te pergjithshme (elektrike, hidraulike) etj.

❖ Shpenzime operative per Arsimin e mesem 10,321.004 leke.  
Te perbera nga: Mirembajtje shkollash 3,000,000 lekë, Energji 720,000 lekë,  
Shperblim i nexenesve ekselente 1,950,000 leke, Materiale pastrimi 225,000 lekë,  
Belet per ngrohje 3, 125,004 leke ndersa pjesa tjeter janë Kanceleri, bojë printeri,  
materiale të pergjithshme ( elektrike, hidraulike) etj.

❖ Shpenzime operative për Rruget Rurale 7,383,550 lekë.

Pjesen kryesore e Karburanti me vlerë 4,123,455 lekë, Kripë 960,000 lekë, pjese kembimi 1,350,000 leke ,Dokumentacion për makineritë 250,095 lekë etj.

❖ Pjesën tjetër të shpenzimeve operative e zenë sektorët e tjere të cilat janë:

Policia Bashkiake 1,119,000 lekë

Kadastra 100,000 lekë.

Zhvilli i Turizmit 1,850,000 lekë.

Ndriçimi Rrugore 3,500,000 lekë.

Ndihma Ekonomike 367,070 lekë.

❖ Ndërsa shpenzimet operative nga transfertat specifike jane si më poshtë:

Infrastruktura e Ujitjes dhe Kullimit:	8,673,993 lekë
Administrimi i Pyjeve:	6,364,851 Lekë
Konvikti Tamare:	609,000 Lekë .
Zjarrfikëset (PMNZH):	8,414,597Lekë.

### III.1.4 Transferta te brendshme

Në këtë grup shpenzimesh futet Kuota e Bashkisë për Qarkun Shkoder dhe shoqaten e bashkive që për vitin 2024 është planifikuar në total në shumën 1,800,000 lekë.

### III.1.5 Fondi rezerve dhe kontigjences

Ne buxhetin e vitit 2025 fondi i rezerves dhe kontigjences, te llogaritur ne zbatim te ligjit per menaxhimin e sistemit buxhetor është parashikuar perkatesisht **2,000,000** lekë dhe rezerve dhe **2,000,000** leke.

*Fondi rezerve* do te perdoret me vendime te vecanta te Keshillit Bashkiak per financimin e shpenzimeve qe nuk mund te parashkohen gjate hartimit te buxhetit.



Fondi i kontigjences do te perdoret te perballuar, nevojen e e kryerjes se financimeve te reja apo shtim te financimeve mbi fondet e miratuara, me vendime te vecanta te Keshillit Bashkiak

### III.1.6 Fondi për Mbrojtjen Civile

Në përputhje me përcaktimet e nenit 65, të ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, Njësitë e vetëqeverisjes vendose duhet të parashikojnë nga burimet e veta të financimit për mbrojtjen civile jo më pak se 1% të totalit të buxhetit. Në zbatim të ligjit të lartë përmendur për vitin 2025 Fondi për Mbrojtjen Civile është në Vlerën 10,144,560 Lekë.

### III.2. Shpenzimet kapitale

Planifikimi i Investimeve për vitin 2025 përshihet në buxhetin afatmesëm 2025-2027 dhe përfshin Investimet që do të financohen për 3 vite buxhetore 2025-2026-2027, ndërsa investimet do të realizohen brënda këtij viti buxhetor. Në buxhet përfshihen gjithashtu edhe investime të realizuara në vitet 2023, 2024 por që do të likujdohen në vitet 2025, 2026, 2027 të cilat janë përfshirë në buxhetin Afatmesëm 2025-2027. Planifikimi i investimeve është bërë duke marrë në konsideratë kërkesat e komunitetit, të Njësisive Administrative dhe të njësisive shpenzuese, në vemendje:

- Analizën e performancës së kryerjes së investimit,
- Shkallën e ndikimit të prithshëm në zhvillimin ekonomik e social,
- Përputhshmërinë me zhvillimet rajonale,
- Numrin e përfituesve nga zbatimi i investimeve,
- Shkallen e ndikimit në reduktimin e varfërisë dhe rritjes së aksesit në kryerjen e shërbimeve ndaj komunitetit,
- Prioritetet e përcaktuara në takimet me komunitetin, duke krijuar mundësinë e vendimmarrjes së qytetarëve në buxhet,
- Investime më shumë në sektorët prioritarë dhe të domosdoshëm për Bashkinë.

#### Aneks 1: Baza ligjore

- Ligj nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligjit nr.68/2017 “Për Financate e Vetëqeverisjes Vendore
- Ligji nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"
- Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomise nr.23 date 30.07.2018 “ Per procedurat standarte te pergatitjes se programit buxhetor afatmesem te NJQV“
- Udhëzimi nr 3. dt.28.02.2024 "Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor

2025-2027"

- Shkresa e Ministrise se Financave me nr. 14488 prot. dt 29.10.2024 "Per Njoftimin Transfertes se Pakushtezuar e pergjithshme dhe sektoriale, per vitin 2025"
- Ligji nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile"
- Ligji nr.10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"
- Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar
- Ligjit 115/2014 datë 31.07.2014 "Për ndarjen Administrative Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.
- V.K.B Nr.185, datë 20.12.2018 "Për miratimin e sistemit të taksave tarifave vendore në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe",Ligji nr.10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".
- Ligjit nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin; VKM nr. 1108 datë 30.12.2015 "Për transferimin,nga Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Adminisrimit të ujrave te Bashkitë ,të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit ,të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale te KullimitLigji nr.10
- VKM nr. 915 ,datë 11.11.2015 "Për transferimin në pronësi nga këshillat e qarqeve te bashkitë të rrejtit të rrugëve rurale dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të ndërmarjes të mirëmbajtjes së këtyre rrugëve"

## INVESTIMET E REJA 2025

		Vlera me tvsh	Tot me tvsh
1	Sistemim asfaltim rruga pojate e Siperme	6,122,428.6	6,282,230
	Supervizim	133,975.5	
	Kolaudim	25,825.9	
2	Riparime me asfalt rruge te brendshme Kopluk	16,315,923.4	16,647,445
	Supervizim	283,676.8	
	Kolaudim	47,844.5	
3	Ure me tombina betoni hyrje Rruga Rranxe Veshtit	3,877,241	4,000,000
	Supervizim	100,033	
	Kolaudim	22,726	
	Supervizim	125,986	
	Kolaudim	24,185	
4	Sistemim Asfaltim rruga e Krevenices Hot	6,973,812.5	7,150,034
	Supervizim	148,052	
	Kolaudim	28,170	
5	Sistemim Asfaltim rruga Mardakajve	4,864,199.0	5,000,000
	Supervizim	112,101	
	Kolaudim	23,700	
6	Sistemim Asfaltim rruga e Liqenit Artificial (Gruemire Çesme)	5,845,343	6,000,000
	Supervizim	129,348	
	Kolaudim	25,310	
7	Sistemim Asfaltim rruga Keraj Boric i Vogel	17,649,136	18,000,000
	Supervizim	300,824	
	Kolaudim		



		50,040	
8	Sistemim Asfaltim degezim rruge ne Omaraj	5,845,343	6,000,000
	Supervizim	129,348	
	Kolaudim	25,310	
9	Sistemim Asfaltim rruga e Vjeter lagja Gril Vrake	9,774,217	10,000,000
	Supervizim	191,277	
	Kolaudim	34,506	
10	Sistemim sheshi Zagore	6,827,217	7,000,000
	Supervizim	146,060	
	Kolaudim	26,724	
11	Sistemim sheshi Xhaj	8,782,804	9,000,000
	Supervizim	185,784	
	Kolaudim	31,412	
12	Ndertim mur mbajtes ne rrugen Zagore Goraj	4,848,835	5,000,000
	Supervizim	125,100	
	Kolaudim	26,065	
13	Sistemim Asfaltim rruga e Xhamise Reç	5,845,343	6,000,000
	Supervizim	129,348	
	Kolaudim	25,310	
14	Sistemim Asfaltim rruga Ulnikaj Reç	17,649,136	18,000,000
	Supervizim	300,824	
	Kolaudim	50,040	
15	Sistemim Asfaltim rruga Reç-Duke	24,554,969	25,000,000
	Supervizim	386,653	
	Kolaudim	58,378	
16	Sistemim Asfaltim rruga Fund Brise-Mukaj Gruemire	7,808,188	8,000,000
	Supervizim	161,594	
	Kolaudim	30,218	

17	Sistemim Asfaltim rruget Zekaj - Zenelaj Koplik Siperme	8,791,095	9,000,000
	Supervizim	176,740	
	Kolaudim	32,166	
18	Sistemim asfaltim rruge te brendshme fshati Dober	26,529,132	27,000,000
	Supervizim	409,569	
	Kolaudim	61,299	
19	Sistemim asfaltim rruga e Rrustemajve ne Culaj	7,808,188	8,000,000
	Supervizim	161,594	
	Kolaudim	30,218	
20	Sistemim asfaltim rruga Rranze e Siperme dhe Gjon Mujaj Vukpalaj	24,554,969	25,000,000
	Supervizim	386,653	
	Kolaudim	58,378	
22	Sistemim Asfaltim rruga e Lagjes Balaj Gradec	4,864,199.0	5,000,000
	Supervizim	112,101	
	Kolaudim	23,700	
21	Sistemim Asfaltim rruga lidhese Gjorm i Poshtem - Ktosh Gruemire	7,808,188	8,000,000
	Supervizim	161,594	
	Kolaudim	30,218	
22	Rikonstruksion i pedonales Koplik	2,919,586	3,000,000
	Supervizim	63,936	
	Kolaudim	16,478	
23	Ndertim stadiumi i Koplikut	100,000,000	102,019,972
	Supervizim	1,964,416	
	Kolaudim	55,556	
24	Fadrome	5,000,000	
25	Eskavator me goma	7,500,000	
26	Blerje kosha mbeturinash	2,000,000	

27	Tabela + Sinjalistike rrugore	7,000,000	
28	Sistem kamera sigurie	8,500,000	
29	Blerje Autoveture	3,500,000	
30	Rikonstrukcion i monumenteve Historike	1,000,000	
	<b>SHUMA</b>	378,749,853	

KRYETAR

TONIN MARINAJ

